

VENDIM
Nr.750, datë 28.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA QENDËR LIBOHOVË, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër Libohovë, të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë), dhe lidhja nr. 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Libohovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Qendër Libohovë										
Nr.	Numri i pasurisë sipas inventarit	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore(EPK), shtrirja gjeografike e EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja ne ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	681	E.K.Libohovë	Bregu i Koçut	1	K.dimërore	153	Kullotë	MMPAU	Komuna	
2	682	E.K.Libohovë	Faqet mbi Libohovë	3	K.verore	85	Kullotë	“	“	
3	683	E.K.Libohovë	Faqe e Bletës	4	K.verore	70	Kullotë	“	“	
4	684	E.K.Libohovë	Palokastra	5	K.dimërore	105	Kullotë	“	“	
3	685	E.K.Libohovë	Arkeovole	7	K.verore	118	Kullotë	“	“	
4	686	E.K.Libohovë	Brinjat e verës	12	K.verore	150	Kullotë	“	“	
5	687	E.K.Libohovë	Rrëza e Skutaratit	13	K.dimërore	143	Kullotë	“	“	
6	688	E.K.Libohovë	Faqe e Gjerë	19	K.verore	132	Kullotë	“	“	
7	689	E.K.Libohovë	Katafiq Haxhi Murati	20	K.verore	127	Kullotë	“	“	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna **Lopës**

Lidhja nr.1

Numrat rendore të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 - 7	Kullota + sip.të tjera	Në pronësi